

VENDIM
Nr.196, datë 10.4.2004

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË MENAXHIMIT NDËRMJET NDËRMARRJEVE TË
UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE TË BASHKIVE DURRËS, FIER, LEZHË E SARANDË
DHE SHOQËRIVE BERLIN WASSER INTERNATIONAL AG E BERLIN WASSER
HOLDING AG, PËR SIGURIMIN E SHËRBIMEVE TË UJIT DHE TË KANALIZIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë” dhe të neneve 10 pika 3/1 shkronja “a” dhe 72 pika 5/1 shkronja “a” të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, të Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së menaxhimit, ndërmjet ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve të bashkive Durrës, Fier, Lezhë e Sarandë dhe shoqërive Berlin Wasser International AG e Berlin Wassert Holding AG, për sigurimin e shërbimeve të ujit dhe të kanalizimeve.

2. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, me cilësinë e Organit Shtetëror të Autorizuar, të kryejnë transferimin e së drejtës së përfaqësimit të pronarit për pronën shtetërore te organet e qeverisjes vendore, nëpërmjet akteve të dorëzimit të objektit të kësaj kontrate.

3. Ngarkohen Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit, Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano